



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	18.09.2025	29.09.2025	2025/0887

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.09.2025, OE “N.T.SH. " AR - DRITI ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0887, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “AGE Group” SH.P.K - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i tribunes Flamurtari” me nr. të prokurimit: "616-25-5377-5-2-1", te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlere e parashikuar e kontrates: 142,733.21€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

AK gjate vleresimit te ketij tenderi ka bere shkelje te ketyre dispozitave ligjore.

NENI 1.Qellimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

NENI 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

NENI 57 Vleresimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas njoftimit per dhenje te kontrates ,konforme ligjit per qasje ne dokumente zyrtare kemi bere kerkese prane AK -Komuna e Prishtines ,e cila na la lejuar qasjen dhe kane qene shume korrekt gjate procedures .

Pas analizes detale nga ekspertet e prokurimit nga kompanija e jone kemi gjetur shume mangesi ne vleresim te ofertes nga ana e komisionit sepse pas analizes sone ,rezulton qe OE "AGE GROUP" SHPK ,eshte si oferte e papergjegjshme konforme kerkesave te dosjes se tenderit .

Sipas kerkeses ne dosja pika 8.1 & 8.2

1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 Euro (60% Bartësi i konzorciumit).

1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo konfirmimin nga banka per qarkullimin e kerkuar.

OE i shpallur fitues ka deshtuar ta permbushë kete pike sepse kerkesa e AK ,ka qene deklaratat e dorezuar ne ATK ne tri vitet e fundit ,ndersa ketij i mungon viti 2024 ,dhe konsiderojme qe nuk e ka permbushur kete pike dhe eshte i papergjegjshem ne permbushjen e kesaj kerkese nga AK.

Tek pika 9.1& 9.2 gjendja ekonomike financiare :

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlere minimale prej 200.0000,00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).(60% Bartësi i konzorciumit).

Gjate analizimit te kontratava te ofruara ne aneksin 6 ,kemi keto te gjetura si ne vijim .OE ne liste te paren e ka ofruar kontraten :

1/Riparimi i monumenteve kulturore dhe historike ,me nr te prokurimit 623-18-7079-521 ne vlere prej 78,846.46 euro .Kjo kontrate eshte nenshkruar me date 15/11/2018,dhe sipas

references se leshuar e cekur nga ditari ndertimor ,punimet kane filluar dy dite me vone me date 17/11/2018.

Nese I referohemi references per punen e kryer te leshuar ne janar 2023 nga drejtori i DKRS-se z.Afrim Dina po citojme : Drejtoria per Kulture,Rini dhe Sport leshone kete reference per kompanine kontraktuese "AGE Group shpk"me seli ne Rahovece,kompanija punimet l ka filluar sipas ditarit ndertimor 17.11.2018 deri 20.11.2020.

Nga kjo shihet qarte se punimet e kesaj kontrate kane perfunduar me date 20.11.2020,ndersa OE AGE group ne Aneksin 6 e ka paraqitur si pune e kryer me date 20.01.2023.Me kete veprim ky Operator ka mashtruar Komunen e Prishtines ,qellimshem per perfitime personale ,duke falsifikuar datat per te permbushur kriteret e kerkuara ,dhe si rrjedhim ka deshtuar te permbush kriterin e kerkuar per gjendjen ekonomike financiare ,dhe eshte l papergjegjshem ,

Meqense ky OE ne baze te deshmive te ofruara ka mashtruar AK -Komunen e Prishtines ,kerkojme nga AK-Komuna e Prishtines te marre masa ndaj ketij OE ,duke e futur ne liste te zeze .

2/kontrata "Ndertimi l QMF-se ne Qifllak vlere 82,996.59 e nenshkruar me date 01.08.2019 e perfunduar me date 20.01.2023

3/Aneks kontrata "Ndertimi l QMF-se ne Qifllak vlere 8105.79 e nenshkruar me date 01.10.2020 e perfunduar me date 20.01.2023.

4/Ndertimi i pllakes perkujtimore Altari i Lirise ,vlere 13.446.00 e nenshkruar me date 11.09.2019,dhe e perfunduar me date 20.01.2023.

Duke pare faktin se keto tri kontrata te cekuar me larte jane vlere te mesme dhe ne shuma te vogla ,si ka mundesi qe realizimi i tyre te zgjate 3 deri 4 vite .

Konstatimi i yne eshte qe OE si ne rastin e pare ka paraqitur keto kontrata qe jane perfunduar me vone qe te permbush kriterin per qarkullim ne tre vitet e fundit ,sepse keto kontrata jane perfunduar me heret ,edhe per qudi te keto tri kontrata jane perfunduar te njejten dite me kontraten e pare me date 20.01.2023.

Njesoj edhe kontratat nen numer rendor 5,6,7,8 jane te nenshkruara ne vitet 2019-2020 dhe njera ne vitin 2021 dhe kane perfunduar ne vitet 2023 dhe 2024 .

Dyshimet jane qe ne te gjitha kontratat e prezentuara ,datat e perfundimit jane ndryshuar me qellim plotesimi te kriterit nga dosja e tenderit .

Ne baze te Aneksit 6 :

Autoriteti Kontraktues ka te drejte te verifikojë te dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e papërgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Kjo eshte marre nga dosja e tenderit dhe kerkojme nga ju qe ti verifikoni te gjitha kontratat e prezentuara gjate kerkeses per rishikim dhe te veproni konforme asaj qe keni ne dosjen e tenderit qe nga OSHP te kerkoni venjien ne listen e zeze te ketij OE .

Sqarim :Verifikimin e kontratave e kemi kerkuar edhe ne si OE ,me poste elektronike duke ju drejtuar Komunes se Rahovecit.

Pra si rrjedhoje konsiderojme qe kerkesen e AK per kontrata ne vlere prej 200,000.00 euro nuk e permbush ky OE dhe eshte i papergjegjshem edhe ne kete pike .

9.1& 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional

Pika 2 : 2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon - Nje Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 2. Dëshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt.

Kontrata e lidhur mes inxh te ndertimit dhe OE nuk eshte ne baze te ligjit te punes sepse nuk permban elementet bazike.

Nuk ka te dhena personale per inxh e angazhuar(datat e lindjes) ,numri personal mungon,personi qe ka nenshkruar ne emer te OE nuk e ka prezentuar autorizimin qe ka nga pronari ,dhe nuk figuron vlera e kompenzimit e parapare me ligje te punes ,dhe si perfundim kjo kontrate nuk permbush as minimumin e ligjit te punes per krijimin e marredhenjies se punes . edhe ne kete pike OE eshte i papergjegjshem .

- Nje Inxhinier i dip. i elektroteknikes apo bachelor (drejtimi elektroenergjetik)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt.

Nuk ka te dhena personale per inxh e angazhuar(datat e lindjes) ,numri personal mungon,personi qe ka nenshkruar ne emer te OE nuk e ka prezentuar autorizimin qe ka nga pronari ,dhe nuk figuron vlera e kompenzimit e parapare me ligje te punes ,dhe si perfundim kjo kontrate nuk permbush as minimumin e ligjit te punes per krijimin e marredhenjies se punes . edhe ne kete pike OE eshte i papergjegjshem .

- Nje Inxhinier i dip. i arkitektures apo ndertimtarise (konstruktiv) min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt.

Nuk ka te dhena personale per inxh e angazhuar(datat e lindjes) ,numri personal mungon,personi qe ka nenshkruar ne emer te OE nuk e ka prezentuar autorizimin qe ka nga pronari ,dhe nuk figuron vlera e kompenzimit e parapare me ligje te punes ,dhe si perfundim kjo kontrate nuk permbush as minimumin e ligjit te punes per krijimin e marredhenjies se punes . edhe ne kete pike OE eshte i papergjegjshem

- Një ekspert për Siguri dhe shëndet ne pune te certifikuar nga MPMS me se paku 3 vjet pervoj pune ne siguri dhe shëndet ne pune nga certifikimi.

Ne kete pike OE ka paraqitur z.Muhamet Hamiti I cili e ploteson kete kriter te parapare nga AK -Komuna e Prishtines .

- Një ekspert te certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri me se paku 3 vjet pervoj pune nga certifikimi.

Edhe per kete kriter OE "AGE GROUP" SHPK ka paraqitur z.Muhamet Hamiti ,I cili e posedon certifikaten e leshuar nga AME ,por nuk ploteson kushtin si ekspert ,sepse e mbulon kerkesen per ekspert nga Sigurija dhe shendeti ne pune ,pra kerkesa e AK ,eshte e qarte per te dy pozitat duhen dy persona te ndryshem ,dhe konsiderojme qe kete pike ka deshtuar ta plotesoj OE.

Sqarim: Sikur kërkesa të ishte një person i qertifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i qertifikuar nga AME si një kërkesë e përbashkët atëherë do ishte në rregull, por kërkesa është për dy pozitat nga një eksperte.

Kërkesa për :

- Dy saldues të certifikuar, kopje të certifikatës apo diplome për salduesit

Kontrata e lidhur mes dy salduesve dhe OE nuk është në bazë të ligjit të punës sepse nuk përmban elementet bazike.

Nuk ka të dhëna personale për salduesit e angazhuar (datat e lindjes), numri personal mungon, personi që ka nënshkruar në emër të OE nuk e ka prezentuar autorizimin që ka nga pronari, dhe nuk figuron vlera e kompenzimit e parapare me ligje të punës, dhe si përfundim kjo kontratë nuk përmbush as minimumin e ligjit të punës për krijimin e marrëdhënies së punës. Edhe në këtë pikë OE është i papërgjegjshëm.

Kërkesa për angazhimin e 10 (dhjetë) punëtorëve

- 10 punëtor tjerë.

Kontrata për marrëdhënie pune apo marrëveshje për angazhim në punë

Duke i analizuar kontratat e punëtorëve vërejmë se ato nuk janë në përputhje me ndryshimet e bëra në ligjin e punës :

Punëtorja Gezime Bala	paga 200.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Dashmir Morina	paga 180.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Muhamed Hajda	paga 200.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Tahir Bala	paga 300.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Sefedin Hamza	paga 200.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Arlind Rexhepi	paga 200.00 euro (40 ore/javë)
Punëtorja Diona Bala	paga 200.00 euro (40 ore/javë)
Punëtori Edvin Dema	paga 200.00 euro (40 ore/javë)

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/ L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 57 të Ligjit

Nr. 03/L-212 të Punës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/1.-142 për Ndryshimin dhe

Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale,

Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore,

në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2024, merr këtë:

1. Aprovohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, në nivelin prej 2.00 € (dy euro) për një orë pune të rregullt, apo 350.00 € (treqindpesëdhjetë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.

2. Paga minimale e përcaktuar në pikën 1 fillon së zbatuari nga data 1 tetor 2024.

Ne baze të ligjit të punës me nr 03/L-212 i plotësuar dhe i ndryshuar

me ligjin 08/L-117 asnjë kontratë e punetoreve të këtij OE nuk e përmbushë këtë ligj dhe si të tilla janë jovalide pasi bien ndesh me ligjin dhe konsiderojmë që edhe në këtë pike OE është i papërgjegjshëm sepse për orar të plotë 40 orë në javë ka paraqitur kompenzim në vlerë prej 180-200.00 euro .

3. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13).3. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13).

Ne baze të dokumentacionit të ofruar nga OE "AGE GROUP SHPK " konstatojmë që ku OE i shpallur fitues ka prezentuar Autorizimin në gjenerale pa i cekur pozicionet 9,12,dhe 13 ,kështu që si pasoje e kësaj nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar për Autorizim me pozicione të caktura dhe në këtë pike është e papërgjegjshme .

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Ne baze të dokumentacionit të ofruar nga OE "AGE GROUP SHPK " konstatojmë që ku OE I shpallur fitues ka prezentuar Katalog në gjenerale pa i cekur pozicionet 9,12,dhe 13 ,kështu që si pasoje e kësaj nuk ka përmbushur kriterin e kerkuar për Autorizim me pozicione të caktura dhe në këtë pikë është e papërgjegjshme.

4. **5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira.**

Te kjo kërkesë kemi keto të gjetura :

- Një kamion të pajisur me shportë (platformë ngritëse) me minimum 10 metra lartësi të ngritjes së shportës.

OE "AGE GROUP SHPK " ka deshtuar ta përmbushë këtë kriter :

Se pari marrëveshja për huazim mes OE "AGE GROUP SHPK " dhe SELMANS NETWORK SHPK " është nënshkruar me datë 24.03.2025 dhe në baza të numrit të prokurimit shihet që është marrëveshje për një tender tjetër i cili është anuluar dhe ka numër tjetër të prokurimit .Pra vijmë në përfundim se marrëveshja nuk vlen edhe nuk është për këtë Aktivitet të prokurimit .

Libreza për kamionin me vinq është me afat të skaduar pa validitet dhe nuk përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues,regjistri i kamionit ka datën 15.04.2025 .

Kamioni me korp i prezentuar është nga Franca dhe nuk ka libere të qarkullimit të Kosovës që nënkupton që nuk përmbush kriterin për pajisje .

Bazuar që marrëveshja me Selmans network shpk ,dhe marrëveshja me Habib Salihun kanë datën 24.03.2025 dhe kanë tjetër numër të prokurimit konsiderojmë që OE "AGE GROUP SHPK ,nuk e ka përmbushur në tërësi kërkesën për pajisje dhe në këtë pikë është i papërgjegjshëm .

Nga të dhënat e prezentuara kërkojmë nga AK-Komuna e Prishtinës që të anulohet vendimi për dëgjime të kontratës dhe lenden ta kthejë në Rivleresim:

Koment :AK-Komuna e Prishtinës ka refuzuar kërkesën për Rishikim ,duke mos i trajtuar asnjë nga pretendimet tona.

VENDIM: Anullohet vendimi i Komunes se Prishtines per dhenjen e kontrates ,dhe aprovohet Ankesa e OE AR-DRITI SHPK dhe lenda kthehet ne Rivleresim .

Sa i perket ofertes sone ,konsiderojme qe perpos qe eshte oferta me e lire edhe eshte e pergjegjshme konforme dosjes se tenderit .

Sqarim : Ne paramasen e tenderuar pozicioni me numer rendor 12 :

Llambë halide metalike me ndezës kuarci 210000 lm ose ekuivalente me 110 lm/W-, të jenë të rezistueshëm ndaj temperaturave nga -30°C deri +50°C , Tensioni 90V - 400V AC 50-60Hz, - Ngjyra 6100 K, Shpërndarja e dritës duhet të deshmohet me llogaritje fotometrike me Software DiaLUX apo të ngjashëm, Jetëgjatësia 6000 orë pune. IEC/EN 60061-1, Te kete mbrojtje nga interferimi i valeve dhe nga mbitensioni deri ne 36kV. Trupi ndriques duhet ti plotësoj këto standarde, Direktiva IEC/EN 60061-1, Deklarata e Komformitetit, Standardi ngjyres se trupit ndriques qe mundeson ftohjen sipas ISO 2808-2007 duke dëshmuar me Certificate. Vrejtje: Trupi ndriques duhet te kete Garancion 5 vite dhe Origjine Europiane, Etiketa e Energjisë nga 2013 duhet te jete A+.

Sa i perket ketij pozicioni ne kemi dorezuar mostren konforme kerkeses se AK dhe me kete edhe e kemi plotesuar kushtin per kete pozicion me mostren qe kemi dorezuar ne AK.

Tek pozicioni 13:

Drosel 2000W magnetik HI 10.3A 400V (venilim) për Llambë halide metalike me ndezës kuarci .

Konsiderojme se vetem ne nga tre pjesmarresit ne kete Aktivitet te prokurimit kemi plotesuar kerkesen e FDT me mostren e ofruar per miratim .

Konstatim: Me te dhenat e ofruara shihet qarte qe oferta e jone eshte e kompletuar ,e pergjegjshme dhe me lira .

A

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë: *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi

**përshtatshmërinë Neni 65
i Ligjit Nr. 04 L-042 ,
Plotësimi i Aneksit Nr. 2
te Dosjes se Tenderit**

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

3. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. Për piken (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për

shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdojë me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është listuar në vendin e dytë.

Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit - Numrin unik identifikues të regjistrimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e Certifikatës së biznesit - numrit unik identifikues të biznesit

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën

Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 Euro (60% Bartësi i konzorciumit).	Tatimore te Kosovës apo konfirmimin nga banka per qarkullimin e kerkuar
Kapaciteti teknik dhe professional: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlere minimale prej 200.0000,00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).(60% Bartësi i konzorciumit).	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> 1. Dëshmia- Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve
2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon - Nje Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.	2. Dëshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt
- Nje Inxhinier i dip. i elektroteknikes apo bachelor (drejtimi elektroenergjetik)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt

- Nje Inxhinier i dip. i arkitektures apo ndertimtarise (konstruktiv) min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.	Deshmia CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt
- Një ekspert për Siguri dhe shëndet ne pune te certifikuar nga MPMS me se paku 3 vjet pervoj pune ne siguri dhe shëndet ne pune nga certifikimi.	- kopje te certifikates sipas kerkeses
- Një ekspert te certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri me se paku 3 vjet pervoj pune nga certifikimi.	- kopje te certifikates sipas kerkeses
- Dy saldues te certifikuar.	- kopje te certifikates apo diplome per salduesit
- 10 punetor tjere.	- Kontrate per marrdhenje pune apo marrveshje per angazhim ne pune
3. Operatori ekonomike duhet te dorëzoj autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13)	3. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13)
4. Operatori ekonomik duhet te dorëzoj katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)	4. Katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.	5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira.
6. Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet të dorëzojë mostrat për produktet e specifikuar në paramasë në pozicionet (9,12,13). (këto produkte duhet të ketë të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet)	6. mostrat për produktet e specifikuar në paramasë në pozicionet (9,12,13) të cilat duhet të dorëzohen në zyrën pritese ditën e hapjes së ofertave para orës 14 00

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Deklaratë:

Komisioni për vlerësimin e ofertave konstatoi se për tenderin Ndertimi i tribunës Flamurtari kanë ofertuar tre OE dhe se i vetmi OE i cili plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e tenderit është OE AGE group SH.P.K.

Komisioni vendosi që me kontratë për ndertimin e tribunës Flamurtari ta shpërblejë OE AGE group Shpk me vlerë të ofertes prej: 142,195.00 euro.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T.SH. " AR - DRITI "

Sqarim hyrës; Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtine, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi I tribunës Flamurtari", me numër të prokurimit: 616-25-5377-5-2-1. Procedura e procedurë e hapur, ndërsalloji i kontratës punë. Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit më datë 16.06.2025.

Më datë 11.09.2025, OE: N.TSH. "Ar-Driti"-Ferizaj, Kosovë, ka paraqitur ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit**, duke kundërshtuar AK-Komunen e Prishtines se gjate vlersimit te ofertave ka shkelur keto nene 1, 6, 7, 57, 68 dhe 69 te LPP-se dhe duke kundërshtuar **Letrën Standarde për Njoftimin e Eliminimit**, me pretendime si në vijim:

Pretendimi nr. 1: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate eshte I pa pergjegjshem ne piken 8.1 dhe 8.2 te Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku nuk ka ofruar qarkullimet nga ATK ne tri vitet e fundit", sipas kriteri te vendosur nga AK ne FDT ka kerkuar:

1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 Euro (60% Bartësi i konzorciumit).

1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo konfirmimin nga banka per qarkullimin e kerkuar

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlereson kete pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson dhe i tejkalon kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në pikat 8.1 dhe 8.2 të Dosjes së Tenderit. Gjithashtu, Formulari i ATK-së per Deklarimin Vjetor per periudhën 2024 gjendet në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr. 2: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate

eshte I pa pergjegjshem ne piken 9.1 dhe 9.2 te Kapaciteti ekonomik dhe financiar,ku nuk ka ofruar kontrata-referencat qe ka kryer pune te kesaj natyre ne tri vitet e fundit”, sipas kriteri te vendosur nga AK ne FDT ka kerkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlerë minimale prej 200.0000,00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).(60% Bartësi i konzorciumit).

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në pikat 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit. OE i rekomanduar ka ofruar një listë të kontratave dhe referencave të realizuara gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, të cilat janë më të vjetra se periudha e kërkuar prej tre (3) viteve të fundit. Përjashtim bën vetëm një kontratë-aneks dhe një referencë nga viti 2021. Te gjitha keto kontrata-referenca ka leshuar AK – Komuna e Rahovecit në vitin 2023/2024, kjo është bërë pas kërkesës së Operatorit Ekonomik dhe nuk e ndryshon faktin se periudha e realizimit të punëve është jashtë afatit të kërkuar.

Asnjëra nga kontratat dhe referencat e ofruara nuk specifikon qartë datën e fillimit dhe përfundimit të punëve, përveç listës së kontratave ku janë shënuar këto data. Megjithatë, në shumicën e rasteve, datat e përfundimit janë identike për kontrata të ndryshme, gjë që ngre dyshime për mundësi manipulimi, pasi nuk përputhen me kontratat dhe referencat përkatëse.

Pretendimi nr. 3: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është I pa përgjegjshem në kriterin 9.1 dhe 9.2 të Kapaciteti ekonomik dhe financiar,pika 2.2.ku nuk ka ofruar dëshmi për stafin profesional” dhe atë si vijon:

2.OE-ik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon - Nje Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

2. Dëshmia: CV, diploma, Kontrata e punës me punëdhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier ndërtimtarie – drejtim konstruktiv, z. Ermal Hoxha, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kërkesat e FDT-se.

- Nje Inxhinier i dip. i elektroteknikës apo bachelor (drejtimi elektroenergjetik)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia: CV, diploma, Kontrata e punës me punëdhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier të elektroteknikës – drejtim elektroenergjetik, z. Bujar Gjocaj, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me

dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në FDT.

- Nje Inxhinier i dip. i arkitektures apo ndertimtarise (konstruktiv) min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Deshmia: CV, diploma, Kontrata e punes me punedhënesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier të ndërtimtarisë dhe arkitekturës, z. Shkëlqim Osmani, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.

- Një ekspert te certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri me se paku 3 vjet pervoj pune nga certifikimi.

- kopje te certifikates sipas kerkeses

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon certifikatën për mbrojtje nga zjarri për z. Muhamet Hamiti, i cili është përfshirë në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: kontratën, diplomën, CV-në, projektet si dhe certifikatat e tjera (përfshirë ISO), në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.

- Dy saldues te certifikuar.

- kopje te certifikates apo diplome per salduesit

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë posedon dy saldues, z. Nexhat Maxhuni dhe z. Jasmin Sliji, për të cilët janë bashkëngjitur certifikatat dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.

Pretendimi nr. 4: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur per kontrate se kontratat e ofruara te puntoreve figurojne me page qe nuk mund te kalojne pagën minimale dhe jane ne kundërshtim me ligjin e punes me nr 03/L-212 i Plotsuar dhe I Ndryshuar me ligjin 08/L-117, asnje kontrate e puntoreve nuk e ploteso kete kusht". AK ne FDT ka kerkuar:

- 10 punetor tjere.

- Kontrate per marrdhenje pune apo marrveshje per angazhim ne pune

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si pjesëshëm të bazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur listën me 13 punëtorë që përmbush këtë kriter. Megjithatë, OE ankues pretendon se në kontratat e punëtorëve të OE të rekomanduar janë paraqitur paga në vlerë prej 180 dhe 200 eurosh, të cilat konsiderohen në

kundërshtim me Ligjin e Punës.

Kjo çështje mbetet në diskrecionin e Autoritetit Kontraktues dhe Operatori Ekonomik duhet të respektojë pagat në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës me Nr. 03/L-212 i Plotsuar dhe I Ndryshuar me ligjin 08/L-117.

Pretendimi nr. 5: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur për kontratë nuk ka ofruar autorizime sipas kriterit të FDT-se dhe autorizimet që ka ofruar janë gjenrale që nuk lidhen me piken 9.12.13 që don të thote nuk e permbushin kete kriter", AK në kriterin e poshtshenuar ka kerkuar:

3. Operatori ekonomike duhet të dorëzojë autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13)

3. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13)

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si pjesshëm të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë posedon autorizime nga kompanitë GAMMASPORT dhe ITE-Kosova, të cilat e autorizojnë kompaninë AGE Group sh.p.k. në përgjithësi. Megjithatë, këto autorizime nuk përfshijnë pozicionet 9, 12 dhe 13, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për mendimin e ekspertit, OE i rekomanduar ka ngarkuar autorizime të përgjithshme në lidhje me projekt.

Pretendimi nr. 6: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur për kontratë ka ofruar kataloge të përgjithshme e jo sipas kriterit AK-se të kerkuar" si me poshte:

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

4. Katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalogje të veçanta, siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues, por ka paraqitur vetëm katalogje të përgjithshme – bllanko, vetëm për të plotësuar kriterin në fjalë.

Pretendimi nr. 6: "Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur për kontratë nuk ka plotsuar kete kriter sipas dosjes se tenderit ne te cilen ka ofruar librezat te automjeteve qe jane pa validitet dhe nuk permbushin kete kriter", AK në FDT ka kerkuar si me poshte:

5. Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.

5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka mareveshje për shfrytëzimin, OE duhet të

dorezohet edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira.

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kriterin në fjalë. Së pari, marrëveshjet e paraqitura janë me data më të hershme se 24.03.2025 dhe me numra të tjerë të procedurave të prokurimit që nuk kanë lidhje me aktivitetin aktual të prokurimit. Gjithashtu, kamioni Mercedes Benz me vlerë më dy dritë, sipas librezës, figuron me afat të skaduar të vlefshmërisë që ka përfunduar më 15.04.2025, çka bën në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në FDT-se.

Për më tepër, kamioni me korpe Renault Master nuk është i regjistruar në Republikën e Kosovës dhe figuron me targa të huaja, të shtetit francez (FS-647-YE). Për këtë automjet është bashkëngjitur një polisë sigurimi me vlefshmëri nga data 07.12.2023 deri më 07.01.2024, që do të thotë se nuk ka sigurim të rregullt për periudhën e realizimit të projektit, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues në FDT).

Pretendimi nr. 7: "Operatori ekonomik ankues konsideron që është i përgjegjshëm dhe plotëson kriteret e ANEKSIT 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Eksperti shqyrtues pas verifikimit të pozicioneve analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se në dokumentacionin teknik të paramasës, pozicioni 12 kërkon furnizimin e trupit ndriçues të llambës halide metalike me ndezës kuarci, me karakteristika të detajuara teknike si: fuqia e dritës 210000 lm, efikasiteti 110 lm/W, jetëgjatësia 6000 orë pune, rezistencë ndaj temperaturave të ndryshme, përputhje me standardet IEC/EN 60061-1, garanci 5 vite dhe origjinë evropiane, ndër të tjera.

Ndërkohë, pozicioni 13 specifikon furnizimin me droselin magnetik 2000W, 10.3A, 400V, i nevojshëm për funksionimin e llambës në pozicionin 12. Ky fakt tregon qartë se trupi ndriçues dhe droseli janë dy elementë të veçantë dhe të ndarë fizikisht, të cilët duhet të furnizohen dhe ofrohen veç e veç.

Në analizën teknike dhe në bazë të dokumentacionit, rezulton se:

Paramasa nuk përfshin dhe nuk kërkon shtepinë ose kutinë montuese të trupit ndriçues si pjesë të detyrueshme për pozicionin 12.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të ofrojnë vetëm elementët e specifikuar në paramasë.

Mosdorëzimi i shtepzës montuese nuk mund të konsiderohet si mospërputhje teknike dhe nuk mund të jetë shkak për refuzimin e ofertës.

Për funksionimin e plotë të sistemit ndriçues, lidhja e trupit ndriçues me droselin është thelbësore dhe kjo lidhje kërkon elementë ndihmës si kabllloja lidhëse, por këto nuk janë pjesë e kërkesave të tenderit.

Në përfundim, oferta që përmban trupin ndriçues (pozicioni 12) dhe droselin (pozicioni 13) në mënyrë të ndarë dhe sipas kërkesave të paramasës është në përputhje të plotë me dokumentacionin teknik.

Pra, duke u bazuar në këtë analizë, mund të konkludojmë se:

Operatorët kanë dorëzuar në mënyrë korrekte dhe të plotë kërkesat për pozicionet 12 dhe 13.

Mospërfshirja e shtepzës montuese, e cila nuk është kërkuar në paramasë, nuk mund të shërbejë si argument për refuzim.

Oferta duhet të pranohet për këto pozicione, pasi përmbush të gjitha kërkesat teknike dhe specifikimet e tenderit.

Ky arsyetim është në përputhje me praktikën e zakonshme të tenderëve dhe standardet evropiane për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve ndriçuese.

PROVE: Paramasa e plotësuar nga OE ankues:

12	Llambë halide metalike me ndezës kuarci 210000 lm ose ekuivalente me 110 lm/W-, të jenë të rezistueshëm ndaj temperaturave nga -30°C deri +50°C, Tensioni 90V - 400V AC 50-60Hz, - Ngjyra 6100 K, Shpërndarja e dritës duhet të deshmohet me llogaritje fotometrike me Software DiaLUX apo të ngjashëm, Jetëgjatësia 6000 orë pune. IEC/EN 60061-1, Te kete mbrojtje nga interferimi i valeve dhe nga mbitemensioni deri ne 36kV. Trupi ndriqes duhet ti plotësoj këto standarde, Direktiva IEC/EN 60061-1, Deklarata e Komformitetit, Standardi ngjyres se trupit ndriqes qe mundeson ftohjen sipas ISO 2808-2007 duke dëshmuar me Certifikate. Vrejtje: Trupi ndriqes duhet te kete Garancion 5 vite dhe Origjine Europiane, Etiketa e Energjisë nga 2013 duhet te jete A+.	copë	1	100.00€	100
13	Drosel 2000W magnetik HI 10.3A 400V (venilim) për Llambë halide metalike me ndezës kuarci.	copë	1	99.00€	99
				Totali me TVSH	135,999.00

Vrejtje: Te gjitha certifikatat e kerkuara ne pozicionet e artikujve te kerkuar, OE fitues eshte i obliguar qe ti paraqes me rastin e furnizimit dhe montimit te artikujve.

Menaxheri i kontrates ka per obligim qe ti verifikoj te gjitha certifikatat e kerkuara per artikujt e kerkuar ne paramase dhe se mbane pergjegjesine per to.



Eksperti shqyrtues rekomandon Autoritetin Kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim, pasi Komisioni i Vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me legjislacionin e Ligjit për Prokurimin Publik. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e FDT-se, prandaj kërkohet që edhe njher të kryhet vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave në përputhje të plot me nenet 7 dhe 59 të LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**N.T.SH. " AR - DRITI "**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndertimi i tribunes Flamurtari**” me numër të prokurimit: “**616-25-5377-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.SH. " AR - DRITI ", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i tribunës Flamurtari" me numër të prokurimit: "616-25-5377-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.SH. " AR - DRITI "**

Burim Guri

